



KONTRATË DHURIMI

E lidhur në Sarandë, sot ditën e hënë, dt. 26/01/2021, ndërmjet palëve:

1. **ERLIND AVDI**, i biri i Bejkushit dhe Hatixhes, lindur në 09/11/1993 në Sarandë dhe banues në Sarandë, Rruga "Butrinti", mbajtës i pasaportes me nr. BE6373068 dhe numer personal J31109087N, i cili në vijim të kësaj kontrate do të quhet **DHURUES**.
2. **Refjon Latifaj**, i biri i Pajtimit dhe Sanies, lindur në 24/06/1987 në Vlorë dhe banuese në Vlorë, Rruga "Hajro Cakeri", mbajtës i letërnjoftimit me nr.036356543, i cili në vijim të kësaj kontrate do të quhet **PËRFITUES**.

Palët, me marrëveshje, me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me nenet 761 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,

VENDOSËN

të lidhin këtë kontratë me kushtet e mëposhtme:

NENI 1

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate janë pjesa e aksioneve të mbetura në masën **49%** të kompanisë **ERLIND BHE shpk**.

Aksionet janë në pronësi të dhuruesit, fakt që provohet nga Ekstrakti QKB historik i bashkangjitur kësaj kontrate. Dhuruesi ka në mënyrë të plotë të drejtën e pronësisë mbi këto aksione, përfshirë këtu dhe të drejtën e dhurimit.

NENI 2

Qëllimi i kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është kalimi pa kundërshtim të pronësisë së aksioneve objekt kontrate, nga dhuruesi tek përfituesi, të cilën ky i fundit shpreh vullnetin për ta pranuar.

NENI 3

Detyrimet e dhuruesit

Dhuresi me vullnetin e tij të plotë merr përsipër t'i japë garanci përfituesit për përkatësinë e aksioneve objekt dhurimi si dhe për cënimin që mund t'i kryhet nga persona të tretë përfituesit gjatë përdorimit të sendit.

Dhuresi duhet të dorëzojë aksionet objekt kontrate në kohën e përcaktuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

NENI 4

Dorëzimi

Dorëzimi aksioneve objekt kontrate nga ana e dhuruesit do të bëhet nga dita e nesërme e nënshkrimit të kontratës nga palët, me datë 27/01/2021. Dorëzimi do të kryhet prane zyrave te QKB Sarande.

NENI 5

Pranimi i përfituesit

Përfituesi i aksioneve objekt kontrate vendosi të pranojë dhurimin duke e vërtetuar këtë edhe me nënshkrimin e tij në fund të kësaj kontrate.

NENI 6

Sanksionet

Dhuresi detyrohet të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë kontratë dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, përndryshe do të jetë përgjegjës sipas rastit.

Dhuresi për mospërmbushjen ose vonesën në dhurim është përgjegjës vetëm për veprime të kryera me dashje ose me pakujdesi të rëndë, pikërisht në ato raste kur përfituesi nuk e realizon dot prej këtyre veprimeve interesin e tij dhe si përfundim humbet qëllimi i kontratës së dhurimit.

NENI 7

Barrët e dhurimit

Në rast të vdekjes së përfituesit përpara dhuruesit, sendi objekt kontrate duhet të kaloj trashgimtareve te perfituesit.

NENI 8

Kësaj kontrate i bashkangjiten dhe janë pjesë e saj: ekstrakti QKB qe provon pronesin nga ana e dhuruesit.

NENI 9

Palët duhet të respektojnë detyrimet që rrjedhin për ta nga kjo kontratë sipas dispozitave që parashikohen në të dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

NENI 10

Për çdo problem palët duhet të komunikojnë me njëra-tjetrën dhe të mundohen t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre dhe vetëm në pamundësi t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë.

PALËT KONTRAKTUESE

DHURUESI

Erlind Avdi

Erlind Avdi

PËRFITUESI

Refjon Latifaj

Refjon Latifaj

